

L I G J
Nr.8543, datë 4.11.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES, DHE TË SHITESËS SË SAJ, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT
VERIOR (NATO) PËR STATUSIN E NATO-S DHE TË PERSONELIT TË SAJ”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja, dhe shtesa e saj, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) për statusin e NATO-s dhe të personelit të saj”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2481, datë 9.11.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

**MARRËVESHJA, DHE SHTESA E SAJ, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR (NATO) PËR STATUSIN E
NATO-S DHE TË PERSONELIT TË SAJ**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe NATO-ja kanë rënë dakord për sa më poshtë :

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, shprehjet që pasojnë do të kenë kuptimet si më poshtë:

- “NATO” ka kuptimin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), organizmave anekse të saj, shtatmadhorive ushtarake të saj, forcave speciale të saj të krijuara dhe elementët/njësitë që formojnë çdo pjesë të një force ose mbështesin një forcë të tillë, pavarësisht nëse ato janë nga një vend anëtar i NATO-s, por nën autoritetin koordinues të NATO-s, që veprojnë në mbështetje të saj duke përgatitur dhe marrë pjesë në operacione.

- “Personeli i NATO-s” ka kuptimin e personelit ushtarak, civil dhe ndërmarrës, caktuar ose bashkuar NATO-s, ose punësuar nga NATO-ja dhe personeli i NATO-s në Republikën e Shqipërisë për çfarëdo operacioni në Republikën e Shqipërisë dhe/ose për vendosjen e një prezence efektive ndërkombëtare civile dhe të sigurimit në Kosovë.

- “Shtatmadhori ushtarak” ka kuptimin e një njësie, pavarësisht nga emërtimi i saj, që konsiston e krijuar ose pjesërisht e krijuar nga personel ushtarak i NATO-s për realizimin e operacionit.

- “Autoritete” ka kuptimin e personave të përshtatshëm përgjegjës, agjencisë ose organizatës në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

- “Personeli kontraktues” ka kuptimin e ekspertëve teknikë ose specialistëve funksionalë, shërbimet e të cilëve janë të kërkuara nga NATO-ja dhe të cilët janë në territorin e Republikës së Shqipërisë ekskluzivisht për t’i shërbyer NATO-s, qoftë në kapacitetin e këshillimit për çështje teknike ose ngritjen e operacioneve e mirëmbajtjen e pajisjeve, ose dhënien e shërbimeve me përjashtim kur ato janë :

(i) qytetarë të Republikës së Shqipërisë; ose

(ii) persona rezidentë të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

- “Përdorim zyrtar” ka kuptimin e të mirave materiale të blera ose shërbimeve të përfuara që synojnë përmirësimin e çdo funksioni sikurse kërkohet nga operacionet e NATO-s.

- “Pajisje” ka kuptimin e ndërtesave, strukturave, premisave dhe terrenin e kërkuar për zhvillimin e aktiviteteve operacionale, stërvitore dhe administrative nga NATO-ja për operacionet sikurse dhe për akomodimin e personelit të NATO-s.

2. Pa paragjykim për privilegjet dhe imunitetet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, i gjithë personeli i NATO-s do të respektojë ligjet e aplikuara në Republikën e Shqipërisë aq sa respektimi i këtyre ligjeve është kompatibël me detyrat/mandatin e ngarkuar dhe do të abstenojë nga aktiviteti jokompatibël me natyrën e operacionit.

3. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë njohin nevojën e procedurave hyrëse dhe dalëse për personelin e NATO-s. Një personel i tillë do të jetë çliruar nga rregullimet për pashaporta dhe vizat, si dhe regjistrimet e aplikuara për të huajt. Në çdo pikë kufiri të hyrjes/daljes në/nga Republika e Shqipërisë personeli i NATO-s do të lejohet të hyjë/dalë në/nga Republika e Shqipërisë mbi bazën e një karte kombëtare identiteti të dhënë dhe në një rregull lëvizjeje të kompletuar në kohën e duhur. Personeli i NATO-s do të mbajë identifikimin që mund t’u kërkohej për t’i paraqitur autoriteteve të Republikës së Shqipërisë, por operacionet, stërvitjet dhe lëvizjet nuk do të lejohet të pengohen ose vonohen nga kërkesa të tilla.

4. Personeli i NATO-s do të veshë normalisht uniformë dhe personeli i NATO-s mund të posedojë ose mbajë armë nëse janë të autorizuar për këtë nga urdhrat e tyre. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë do të pranojnë si të vlefshme, pa taksa ose shpenzime, patentat për drejtimin e makinave dhe lejet e delivruara personelit të NATO-s nga autoritetet e tyre respektive kombëtare.

5. NATO do të lejohet të shpalosë flamurin e NATO-s dhe/ose flamujt kombëtarë të elementëve/njësive përbërëse në çdo uniformë të NATO-s, mjete transporti ose pajisje.

6. a. NATO-ja do të ketë imunitet nga të gjitha proceset juridike, qofshin ato civile, administrative ose kriminale që vijnë nga çdo akt dhe/ose gabim brenda Republikës së Shqipërisë.

b. Personeli i NATO-s në çdo rrethanë dhe kohë do të jetë subjekt ekskluzivisht i elementëve të juridiksionit të autoriteteve të tyre respektive kombëtare për infraksionet civile, administrative ose kriminale ose disiplinore të cilat mund të kryhen nga ana e tyre në Republikën e Shqipërisë. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë do të ofrojnë asistencë shteteve pjesëmarrëse në operacion, për ushtrimin e juridiksionit ndaj vetë qytetarëve të tyre.

c. Komanda e NATO-s do të ketë të drejtë të heqë dorë në favor të autoriteteve të Republikës së Shqipërisë, nga juridiksioni për çdo/dhe të gjitha infraksionet e bëra në Republikën e Shqipërisë, por vetëm ato lidhur me personelin kontaktues, të cilët nuk janë subjekt i juridiksionit të vendeve të nënshtetësisë së tyre dhe vetëm pas konsultimit me vendin e nënshtetësisë të personelit kontraktues.

7. Personeli i NATO-s do të ketë imunitet nga çdo lloj forme arrestimi, hetimi ose burgimi nga autoritetet në Republikën e Shqipërisë. Personeli i NATO-s i arrestuar gabimisht do t’u kthehet menjëherë autoriteteve të NATO-s.

8. Personeli i NATO-s, bashkë me automjetet e tyre, anijet, avionët dhe pajisjet do të ketë të drejtën e kalimit të lirë dhe të pakufizuar dhe aksesit të papenguar në Republikën e Shqipërisë përfshirë hapësirën ajrore bashkëngjitur dhe ujrat territoriale. Kjo do të përfshijë, por jo e kufizuar në të, të drejtën e fushimit manovrës, banimit dhe përdorimit të çdo sipërfaqeje ose pajisjeje që kërkohet për mbështetje, stërvitje dhe operacione.

9. NATO-ja do të çlirohet nga taksat dhe ngarkesat e tjera dhe inspektimet e rregullimet doganore, përfshirë paraqitjen e inventarëve ose dokumentacionit tjetër rutinë për doganat, për personelin, automjetet, mjetet e lundrimit, ato të fluturimit, pajisjet, furnizimet që hyjnë, dalin ose kalojnë tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë nga/ose për llogari të NATO-s në mbështetje të Operacionit.

10. Autoritetet në Republikën e Shqipërisë do të lehtësojnë mbi baza prioritare dhe me të gjitha mjetet e duhura, të gjitha lëvizjet e personelit, automjeteve, mjeteve të lundrimit, atyre të fluturimit, furnizimeve, përmes ose në hapësirën ajrore, portet, aeroportet ose rrugët e përdorura. NATO-s nuk do t’i ngarkohen shpenzime për fluturime, uljen ose ngritjen e avionëve të NATO-s, pavarësisht nëse janë pronë qeveritare ose të porositur. Në mënyrë të ngjashme, NATO-s nuk do t’i ngarkohen shpenzimet për mjetet e lundrimit, për hyrjen e daljen e tyre nga portet, pavarësisht nëse janë pronë qeveritare ose të porositur. Automjetet, mjetet e lundrimit dhe avionët e përdorur në

mbështetje të Operacionit nuk do t'i nënshtrohen kërkesave të licensimit ose të regjistrimit dhe as sigurimit tregtar.

11. NATO-s i garantohet përdorimi i aeroporteve, rrugëve, hekurudhave dhe porteve pa paguar taksa ose detyrime që rrjedhin nga përdorimi i tyre. Megjithatë, NATO nuk do të kërkojë përjashtimin nga pagesat e arsyeshme për shërbime të veçanta, të kërkuara dhe që i janë bërë, por operacionet/lëvizja dhe aksesit nuk do të lejohet që të pengohen nga pagimi i këtyre shërbimeve.

12. Personeli i NATO-s do të përjashtohet prej taksimit nga Republika e Shqipërisë mbi pagat dhe shpërblimet e marra nga NATO dhe mbi çdo të ardhur tjetër të marrë nga jashtë Republikës së Shqipërisë ose çdo vendi tjetër pjesëmarrës në Operacion.

13. NATO dhe personeli i NATO-s, si dhe pronat e tyre të lëvizshme të importuara në, blerë në, apo të eksportuara nga Republika e Shqipërisë nga ose në emër të NATO-s apo personelit të NATO-s përjashtohen nga të gjitha taksat, tatimet dhe detyrime të tjera apo inspektime dhe detyrime doganore të Republikës së Shqipërisë.

14. Aktivitetet e NATO-s, qendra dhe personeli përjashtohen nga të gjitha tatimet, taksat, pagesat dhe detyrime të ngjashme. Veçanërisht, NATO lejohet të importojë dhe të eksportojë pa taksa doganore dhe detyrime të tjera pajisje, ushqime dhe rezerva të kërkuara nga NATO për operacionin, me kusht që mallra të tilla të jenë vetëm për përdorim zyrtar të NATO-s ose për shitje për personelin e NATO-s. Mallrat e shitura janë vetëm për përdorim nga personeli i NATO-s dhe të patransferueshme tek persona të paautorizuar.

15. Autoritetet në Republikën e Shqipërisë janë të ndërgjegjshme se përdorimi i kanaleve të komunikimit është i nevojshëm për Operacionin. NATO lejohet të operojë (përdorë) shërbimet e veta të postës së brendshme. Republika e Shqipërisë, në bazë të një kërkesë të thjeshtë, i jep të gjitha shërbimet e telekomunikacionit, duke përfshirë edhe shërbimet e radiopërhapjes (broadcast services), të nevojshme për Operacionin, siç gjykohet nga NATO. Këtu përfshihet e drejta për të përdorur mjete dhe shërbime të tilla që kërkojnë për të siguruar aftësi të plotë komunikimi dhe të drejtën për të përdorur të gjithë spektrin elektromagnetik për këtë qëllim, pa pagesë. Në zbatimin e kësaj të drejte, NATO përdor të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të koordinuar, si dhe merr parasysh nevojat dhe kërkesat e autoriteteve përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

16. Autoritetet në Republikën e Shqipërisë japin, pa pagesë, lehtësira të tilla publike sipas kërkesës së NATO-s për përgatitjen dhe zbatimin e Operacionit. Autoritetet në Republikën e Shqipërisë ndihmojnë NATO-n në sigurimin, në tarifatat më të ulta, të të gjitha shërbimeve si elektricitet, ujë dhe gaz, të cilat do të kërkojnë nga NATO për Operacionin.

17. NATO do të zbatojë një proces sa më të shpejtë që të jetë i mundur, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, për të koordinuar trajtimin e pretendimeve për dëmtime ose plagosje ndaj personelit ose pronës së qeverisë – me përjashtim të personelit e forcave të armatosura dhe/ose të pronës të zotëruar dhe në përdorim të forcave të armatosura – dhe të personelit ose pronës private të Republikës së Shqipërisë.

18. NATO do të lejohet të kontrakttojë direkt për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve nga çdo burim brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Kontrata të tilla, mallra dhe shërbime nuk do t'i nënshtrohen pagesës e detyrimeve, taksave dhe shpenzimeve të tjera. NATO, gjithashtu, mund të kryejë punime ndërtuese me personelin e saj.

19. Njësitë tregtare të regjistruara në mënyrë të rregullt ose me bazë jashtë Republikës së Shqipërisë, të cilat ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë vetëm në shërbim të NATO-s, do të përjashtohen nga ligjet dhe rregullimet e Republikës së Shqipërisë në lidhje me kushtet dhe termat e punësimit, licensimit dhe të regjistrimit të të punësuarve, bizneseve dhe korporatave.

20. NATO mund të punësojë personel lokal, të cilët në bazë individuale do t'i nënshtrohen ligjeve dhe rregullimeve lokale me përjashtim të ligjeve të punës/punësimit. Sidoqoftë, punonjësit lokalë të punësuar nga NATO :

a) do të kenë imunitet nga procese ligjore lidhur me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha aktet e kryera nga ta në cilësinë e tyre zyrtare;

b) do të kenë imunitet nga shërbimet kombëtare dhe/ose detyrimet e shërbimit ushtarak kombëtar vetëm gjatë periudhës së punësimit të tyre nga NATO dhe;

c) do t'i nënshtrohen vetëm kushteve dhe termave të punësimit të vendosura nga NATO vetëm për periudhën e punësimit të tyre nga NATO.

21. Gjatë drejtimit të Operacionit, NATO mund të ketë nevojë të bëjë përmirësime ose

modifikime ndaj disa infrastrukturave, ndër të tjera, rrugë, ura, tunele, ndërtesa, sisteme shërbimi të Republikës së Shqipërisë. Përmirësime dhe modifikime të tilla të një karakteri jo të përkohshëm do bëhen pjesë e strukturës ekzistuese dhe do të ambientohen, pa kosto në përfitim të pronarit. Përmirësime ose modifikime të përkohshme mund të hiqen me vendim të komandantit të NATO-s dhe infrastruktura të rikthehet sa më pranë kushteve fillestare, duke pasur parasysh edhe një konsumim të pritshëm.

22. Në qoftë se nuk do të përmbushet ndonjë zgjidhje e përshkruar më sipër, mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen ndërmjet NATO-s dhe Republikës së Shqipërisë në mënyrë të pështatshme.

23. Rregullime shtesë me ndonjë nga palët mund të përfundohen me qëllim që të lehtësohen detaje të lidhura me Operacionin.

24. Klauzolat e kësaj marrëveshjeje do të mbeten në fuqi deri në përfundimin e Operacionit ose si të bien dakord palët në një mënyrë tjetër.

25. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, klauzolat e Partneritetit për Paqe SOFA do të zbatohen në lidhje me Operacionin.